

Zgjedhjet Parlamentare 25 Prill 2021

RAPORT MONITORIMI

Mbi disa gjetje dhe konkluzione nga vëzhgimi i grupit të monitoruesve të organizatës “Intelektualët e Rinj, shpresë” në Bashkinë Shkodër.

Qershor 2021

©Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë”

Ky raport u përgatit me iniciativën e shoqatës “Intelektualët e rinj, Shpresë”, në kuadër të projektit “Dëgjo Zërin Tim” si pjesë e projektit “Unë marr pjesë. Zëri im, vota ime vlen” mbështetur nga Bashkimi European dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në partneritet me CIVIL RIGHTS DEFENDERS dhe Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies.

Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikpamjet e donatorit.

Tabela e Përmbajtjes:

1. Vështrim i përgjithshëm.....	<i>faqe 4</i>
2. Objektivat.....	<i>faqe 5</i>
3. Analizë e Legjislacionit.....	<i>faqe 6</i>
4. Monitorimi	<i>faqe 7</i>
5. Gjetje dhe Rekomandime.....	<i>faqe 13</i>

1.Vështrim i përgjithshëm

Organizata “Intelektualët e rinj, Shpresë” është një organizatë e shoqërisë civile e cila ka si mision dhe punon për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri si dhe promovimin e Paqes dhe Stabilitetit në Ballkan.

Zgjedhjet janë parakusht për qeverisjen demokratike, pasi nëpërmjet tyre qytetarët e një vendi zgjedhin lirisht dhe bazuar në ligj personat që mund të qeverisin në mënyrë legjitime në emër dhe në interes të tyre. Mbajtja e zgjedhjeve demokratike të cilat marrin parasysh të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe që janë të bazuara në sundimin e ligjit, në fund të fundit kontribuon në krijimin e procedurave dhe institucioneve që formojnë qeverisjen e mirë. Pikërisht për këto arsye zgjedhjet dhe proceset zgjedhore vazhdojnë të kenë vëmendjen e organizatave të shoqërisë civile në vendin tonë.

“Intelektualët e rinj, Shpresë” si një organizatë e shoqërisë civile ka monitoruar zgjedhjet parlamentare të 25 Prill 2021 në Bashkinë Shkodër me një grup prej 30 vëzhguesish. Vëzhgimi është realizuar në kuadër të zbatimit të nismës , përkatësisht “Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen” mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian”, dhe nga Republika Federale Gjermane.

Prania e vëzhguesve në qendrat e votimit mbetet elementi kryesor i përpjekjes për vëzhgim. Në të njëjtën kohë, teknikat për vëzhgimin e zgjedhjeve kanë përparuar, duke sjellë ndryshime të rëndësishme në shpërndarjen e vëzhguesve, mbledhjen e të dhënave, raportimin, etj. Këto ndryshime reflektojnë vlerësim më të madh për rëndësinë e kulturës politike dhe kuptim të mprehtë të nevojës për më shumë vlerësim sistematik të cilësisë së procesit zgjedhor. Reflektimi dhe interpretimi i vazhdueshëm i standardeve ndërkombëtare dhe i praktikave të mira zgjedhore e ka bërë më të lehtë për vëzhguesit që ta vlerësojnë procesin zgjedhor në tërësi dhe të kuptojnë pjesët e ndryshme të tij.

Në Bashkinë Shkodër rezulton që ka 411 Qendra Votimi .Numri total i zgjedhësve në listë 272078 , Numrat e votuesve në qendrat e votimit ishte 113897. Vëzhguesit kanë monitoruar disa nga këto qendra votimi ku kanë raportuar mbi mbarvajtjen e procesit të votimit në këto qendra.

Konkretisht qendrat e monitoruara janë :

Nr	Nr.QV	Nr.i votuesve në listë	Nr.total i votuesve	Nr.i votuesve femra
1	0180	971	322	169
2	0145	738	291	146
3	0156	723	273	143
4	0202	548	199	101
5	0225	486	220	105
6	0229	437	102	56
7	0236	689	258	123
8	0236/1	683	355	166
9	0239	787	367	177
10	0242	834	476	252
11	0242/1	499	283	138

12	0250	716	353	171
13	254/1	476	174	4
14	0259	847	414	199
15	0260	945	344	175
16	0261	630	324	177
17	0265	861	336	167
18	0274	676	260	123
19	0279	606	246	120
20	0280	864	371	202
21	0288	879	406	208
22	0290	858	423	218
23	0297	799	418	216
24	0298	755	401	209
25	0304	756	363	176
26	0305	704	241	114
27	0306	873	283	143
28	0311	612	210	108
29	0314	909	330	158
30	0314/1	578	198	100

2. Objektivat

➤ ***Sigurimi i një opinioni të informuar, të pavarur, dhe të paanshëm në procesin zgjedhor.***

Intelektualët e Rinj, Shpresë si një organizatë civile e vëzhgimit të zgjedhjeve ofron raporte dhe deklarata publike të paanshme dhe të bazuara në prova, të cilat shpërndahen gjerësisht ndërmjet aktorëve kyç zgjedhorë me qëllim sigurimin e informacionit rreth gjetjeve pozitive dhe mangësive të procesit zgjedhor.

➤ ***Promovimi i transparencës në procesin zgjedhor dhe sigurimi i integritetit të procesit.***

Objektivi është që të kontribuojë për rritjen e besimit në procesin zgjedhor, shtrirjen e llogaridhënies për zgjedhjet, si dhe për pranimin e rezultateve nga kandidatët. Në çdo situatë të caktuar, vetëm thjesht prania e vëzhguesve në qendrën e votimit nuk duhet të shihet si legjitimim ose rritje e besueshmërisë tek procesi zgjedhor.

➤ ***Shkurajimi i mashtrimit zgjedhor dhe ulja e nivelit të manipulimit apo dhunës të lidhur me zgjedhjet.***

OShC-të që kryejnë vëzhgim vendor të zgjedhjeve, thjesht me pranimin e tyre në qendrat e votimit, ose në kontekste të tjera të lidhura me zgjedhjet, mund të shkurajojnë shkelësit e mundshëm të ligjit dhe të procedurave zgjedhore. Nga kjo perspektivë, aktivitete të tilla të vëzhgimit të zgjedhjeve mund të shihen si masë parandaluese për të shkurajuar manipulimin e mundshëm të zgjedhjeve.

3. Analizë e Legjislacionit

E drejta për zgjedhje të lira garantohet nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ndër gjithë garancitë demokratike kundër abuzimit të pushtetit politik, e drejta për zgjedhje të lira është një ndër të drejtat më themelore. Aftësia e individëve për të shprehur identitetet dhe përzgjedhjet e tyre në mënyrë paqësore në kutinë e votimit është thelbësore për stabilitetin e çdo shoqërie, por edhe për sigurinë demokratike të Evropës. Për pasojë, detyrat që kryhen nga vëzhguesit zgjedhorë janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Zgjedhjet duhet të përgatiten me kujdesin e duhur dhe me integritet, ndërsa vëzhguesit duhet t'i ushtrojnë detyrat e tyre me paanshmëri dhe transparencë. Prania dhe profesionalizmi i tyre ndihmon për të siguruar besimin e zgjedhësve dhe atë të komunitetit ndërkombëtar¹.

- **Sipas Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë të drejtën për të caktuar vëzhgues e kanë ndër të tjerë dhe OJF-të . Neni 6 pika 2²: *Organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të medias kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues në zgjedhje.***

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve

1. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, vëzhguesit kanë këto të drejta:

- a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;
- b) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;
- c) të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor;
- ç) të drejta të tjera të përcaktuara në këtë Kod apo në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Vëzhguesit kanë këto detyra:

- a) të respektojnë kërkesat e këtij Kodi dhe udhëzimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve;
- b) të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat, parti apo koalicion në qendrat e votimit ose në vende të tjera të ndaluara sipas këtij Kodi;
- c) të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja, si dhe me një dokument identifikimi të pranuar nga KQZ-ja;
- ç) të mos mbajnë shenja dalluese, që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit; d) të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit, të numërimit dhe administrimit të zgjedhjeve.

¹<https://rm.coe.int/16806fb934> Botim i Këshillit të Evropës për organizatat e shoqërisë civile

²Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

4.Monitorimi

Monitorimi i përqëndrua në pikat e mëposhtëme:

A.Qendra e votimit

B.Fillimi i procesit të votimit

C.Ecuria e procesit të votimit

Ç.Mbyllja e procesit.

Në mënyrë të përmbledhur, nga monitorimi i disa aspekteve të rëndësishme të procesit zgjedhor rezulton se:

A.Qendra e Votimit

Zgjedhjet Parlamentare të dt.25 Prill u zhvilluan në kushtet e Pandemisë globale, për shkak të virusit “Covid 19”. Me datë 13.04.2021 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miratoi Protokollin “Lidhur me masat anti Covid-19 gjatë procesit zgjedhor dhe ditës së votimeve”. Vëzhguesit e organizatës “Intelektualët e Rinj , Shpresë” u trajnuan lidhur dhe me respektimin e këtij protokollit si nga vëzhguesit, por edhe për evidentimin e problematikave lidhur me mosrespektimin e këtij Protokollit në qendrat e votimit.

Vëzhguesit kanë monitoruar dhe mbi respektimin e protokollit lidhur me masat anti Covid-19. Nga monitorimi rezulton se në pjesën më të madhe të qendrave të votimit ky protokoll është zbatuar, por ka pasur qendra me fluks të lartë të qytetarëve dhe grumbullim në ambjentet e mbrendshme të qendrave të votimit, ku ka qenë e vështirë ruajtja e distancimit fizik.Gjithashtu vërehet prania e një personi i cili mbante rradhan në pjesën më të madhe të qendrave të votimit.

➤ Prania e materialeve propaganduese

Kodi Zgjedhor e ndalon vendosjen e materialeve propogandistike në qendrat e votimit.Në nenin 101 pika 1/b të Kodit Zgjedhor parashikohet :*KQV-ja, nën drejtimin e kryetarit dhe sekretarit dhe në prani të vëzhguesve të subjekteve, një orë përpara hapjes së votimit, kryen këto detyra: b) heq materialet propagandistike që mund të ndodhen në qendrën e votimit dhe rreth saj në një rreze prej 150 m.*

Nga vëzhguesit nuk rezulton që të jenë realizuar veprimet e përshkruara më sipër nga ana e anëtarëve të komisionit, sepse nuk ka pasur prani të materialeve propaganduese .

B.Fillimi i procesit të votimit

Në përgjithësi procesi ka nisur i qetë dhe pa probleme të rëndësishme.

Nga vëzhguesit në terren është vërejtur një vonese e fillimit të procesit të votimit ku shkak i kësaj vonese ka qënë kryesisht problematika lidhur me paisjen e identifikimit elektronik (vendosja në funksion, instalimi, mosnjohja e gjyrmeve të gishtërijnve).

-Në Njësine Administrative Ana e Malit në QV nr. 0202 procesi i votimit ka filluar me vonesë për shkak se pajisja e identifikimit elektronik e votuesve ka shfaqur probleme dhe procesverbali nuk ishte gati dhe për pasojë qendra u hap për votuesit në orën 07:25.

-Në Bashkinë Shkodër në qendrën e votimit 0242/1 ,shkolla “Ismail Qemali” procesi ka filluar me vonesë për shkak të problemeve me vula dhe bazës materiale(nga vëzhguesi u raportua që njera nga kutitë ishte e thyer, por kjo kuti u zëvendësua me një kuti tjetër).

-Në Njësine Administrative Dajç qendra e votimit 0225 ka patur problematikë lidhur me funksionimin e pajisjes së identifikimit elektronik.

-Në qendrën e votimit nr. 0319/1 votimi ka filluar rreth orës 07:40 sepse ka patur probleme në plotësimin e procesverbalit.

Në qendrat e tjera të monitoruara nga vëzhguesit numerimi ka filluar në orën 7:00 dhe nuk ka pasur problematika në hapjen e qendrave të votimit dhe fillimin e procesit.

Vihet re se këto vonesa kanë ardhur si rezultat i mos instalimit më heret të paisjes së identifikimit elektronik dhe të kamerave ,pasi punojësit e KQZ që realizojnë këtë shërbim janë trajnuar për ti instaluar menjëherë pas marrjes së bazës materiale nga KQV më 24.04.2021 dhe rezultoi se në pjesën më të madhe të qendrave të monitoruar këto paisje janë instaluar vetëm pak minuta para fillimit të procesit të votimit(orës 7:00).

Në Bashkinë Shkodër në qendrën e votimit nr.0311 anëtari i komisionit kishte ngatërruar qendrën dhe si pasojë ka patur probleme në procesin e votimit duke e vonuar atë deri në sisteminin në qendrat përkatëseve të komisionerve.

C.Ecuria e procesit të votimit

➤ Infrastruktura elektronike zgjedhore

Përdorimi i sistemit PEI i ka gjetur të papërgatitur anëtarët e KQV sepse vonesat më të mëdha janë shkaktuar nga mosfunksionimi i këtij sistemi në disa prej QV-ve. Duke qënë se gjatë procesit të votimit zgjedhësit janë identifikuar nëpërmjet pajisjes elektronike është vënë re se nuk është zbatuar respektimi i procedurave të detyrueshme të votimit të parashikuar në nenin 105 të Kodit Zgjedhor, si heqja e vizës emrit të zgjedhësve në listën e zgjedhësve apo nënshkrimi i zgjedhësit përbri emrit në listë. Konkretisht në QV 0319/1 procesi kryhej me anë të pajisjes elektronike dhe lista e zgjedhësve përdrorej në raste të veçanta të mosfunksionimit të pajisjes elektronike. Si rrjedhojë e aplikimit të identifikimit elektronik ose biometrik të zgjedhësve, KQV-të vërehet të mos kenë ndjekur një praktikë të unifikuar për respektimin e procedurave të detyrueshme të votimit të parashikuar në nenin 105 të Kodit Zgjedhor, si heqja

e vizës se emrit të zgjedhësve në listën e zgjedhësve apo nënshkrimi i zgjedhësit përbri emrit në listë³.

Konkretisht në qendrat e poshtë shënuar ka pasur këto problematika të evidentuara:

- QV 0242 pajisja nuk ka funksionuar dhe identifikimi është shënuar manualisht
- QV 0225 problem me pajisjen (PEI) nuk lexonte kartat dhe nuk lexonte shenjat e gishtërinjve.
- QV 0236/1 problem me pajisjen (PEI) nuk lexonte shenjat e gishtërinjve.
- QV 0280 problem me pajisjen (PEI) lidhur me funksionimin .
- QV 0306 pajisja(PEI) nuk lexonte shenjat e gishtërinjve kryesisht të moshuarve.

➤ Identifikimi i zgjedhësve

Në pothuajse të gjitha qendrat e votimit të monitoruara nga vëzhguesit tanë rezulton që janë zbatuar rregullat e parashikuara nga Kodi Zgjedhor lidhur me verifikimin e të dhënave të identitetit kur zgjedhësi paraqet dokumentin e identifikimit.

Sipas Kodit Zgjedhor neni 105 pika dh) *zgjedhësi timbroset në dorën e majtë nga një anëtar i caktuar me vendim të KQV- së me një lëndë të posaçme, të dukshme me shikim të lirë dhe që nuk hiqet për jo më pak se 24 orë, me qëllim shmangien e votimit më shumë se një herë dhe më pas i jepet fleta e votimit. Në rast se zgjedhësi nuk pranon të timbroset me lëndën e posaçme, atij nuk i jepet fleta e votimit dhe identiteti i tij mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV- së*

Ka pasur raste ku parashikimet e nenit të mësipërm nuk janë respektuar nga anëtarët e komisionit të votimit. Nga monitoruesit është vënë re se disa qytetarë timburoseshin në dorën e djathtë dhe jo në dorën e majtë, sipas rregullave që parashikon ligji, po ashtu ka patur raste kur qytetari nuk është timburosur dhe kjo është raportuar në QV 0305. Problematikë tjetër ka qenë edhe moskontrollimi i të dyja duarve nga komisioni i qendrës së votimit sipas rregullave të parashikuara në Kodin Zgjedhor (një prej anëtarëve(i KQV), i caktuar me vendim të KQV- së, kontrollon zgjedhësit në të dy duart, në çastin e paraqitjes para KQV-së dhe para marrjes së fletës së votimit, nëse është timbruar ose jo me lëndën e posaçm⁴).

➤ Procedurat për zgjedhësit të cilët nuk mund të votojnë vetë

Në të gjitha qendrat e votimit janë raportuar raste kur i është ofruar mbështetje për të ushtruar të drejtën e votës personave të cilët për arsye fizike nuk kanë mundur të votojnë vetë. Në pjesën më të madhe të QV-ve janë respektuar rregullat e parashikuara nga neni 108 i Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet që zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë. Konkretisht në QV 0311 nga raportimi i

³QVQV 0274, 0260 (Bashkia Shkoder),

⁴ Neni 105 pika 1/b e Kodit Zgjedhor

vëzhguesit rezulton se individ i cili për arsye të ndryshme nuk ka mundur të votojë vetëështë shoqëruar nga një familjar dhe për këtë është mbajtur një proces verbal i cili u firmos nga familjari dhe kryetari i komisionit. Sipas rregullave të parashikuara në Kodin Zgjedhor⁵ për këtë rast personi që ndihmon duhet që para se të shënojë në fletën e votimit, personi që ndihmon një zgjedhës tjetër bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së se do të votojë sipas udhëzimeve, se nuk do të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, se nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër në rastin e mësipërm vërehet se është mbajtur vetëm një procesverbal .

Jo vetëm që nuk kanë respektuar rregullat e parashikuara nga Neni 8 i Kodit Zgjedhor por kanë lejuar dhënien e ndihmes nga personat e tjerë pa bërë deklaratën në Librin e Protokollit dhe pa mbajtur qoftë dhe një procesverbal . Konkretisht në QV 0314/1 është lejuar dhënia e ndihmës nga personat të tjerë pa mbajtur procesverbal. Në QV 0236/1 është raportuar se persona të tillë janë ndihmuar nga familjarët por edhe nga anëtarët dhe kryetari i komisionit. Gjithashtu edhe në qendra të tjerat vëzhguesit kanë raportuar se personat të cilët nuk mund të votonin vetë për shkak të ndryshme janë shoqëruar nga familjarë.⁶

Në QV 254/1, për shkak të pamundësisë për të shikuar fletën e votimit, zgjedhësi u asistua nga një person tjetër që u përpoq të influenconte në vendimin e tij, por KQV nuk e lejoi këtë.

➤ **Përshtatja e arsyeshme për personat me aftësi të kufizuar**

Sipas nenit 3 pika 3 e Kodit Zgjedhor: “Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod.” Sa i përket respektimit të këtij parimi nga vëzhguesit u evidentuan qendra të cilat nuk kishin një përshtatje për personat me aftësi të kufizuar (në këtë mënyrë ushtrimi i të drejtës për të zgjedhur për këta persona bëhet i vështirë për shkak të mos ofrimit të kushteve të përshtatshme për këta persona në qendrat e votimit). Duke e lidhur dhe me atë që u përmend më sipër këto persona nuk mund të votojnë pa ndihmen e personave të tjere çka mund të imponojë dhe vullnetin e tyre.

➤ **Fshehtësia e votës**

Vëzhguesit kanë monitoruar me kujdes gjatë gjithë ditës ecurinë e procesit të votimit dhe kanë raportuar për çdo problematikë. Problematikat e raportuara kishin të bënin lidhur me mos zbatimin e rregullave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor. Konkretisht në qendrën e votimit nr.0304 u shfaq një problematikë ku një votues doli me fletë të hapur nga dhoma e fshehtë duke evidentuar qartë votën⁷. Ndërsa në qendrat e tjera të votimit të monitoruara nuk ka patur problematika të evidentuara lidhur me fshehtësinë e votës.

⁵ Neni 8 pika 3 e Kodit Zgjedhor

⁶ QV 0314/1

QV 0306 një person u ndihmua nga dikush që ndodhej rastësisht aty

QV 0298 , QV 0239, QV 0261, QV 0319/1 , QV (0280) , QV(0311), QV (0288), QV (0225)

QV (0250), QV (0319/1), QV (0274) , QV (0297), QV (0156), QV (0145) janë ndihmuar nga familjarët

⁷ Kodi Zgjedhor Neni 106 pika 2 : “Zgjedhësi, pasi bën shënimin në fletën e votimit, palos fletën e votimit, në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, por të paktën një nga vulat në pjesën e pasme të fletës të jetë e dukshme.

➤ **Votimi Familjar**

Votimi familjar ndodh kur disa persona, me justifikimin e afërsisë familjare, votojnë në të njëjtën qendër votimi dhe njëkohësisht në dhomen e fshehtë. Votimi familjar ndodh zakonisht kur një person i gjinisë mashkullore voton në kabinë në të njëjtë kohë kur voton personi i gjinisë femërore nisur nga problematikat e votimit familjar të evidentuara ndër vite. Një rast i tillë ku bashkëshorti shoqëroi gruan e tij në dhomën e fshehtë, ka ndodhur në qendrën e votimit nr.311 rasti u evidentua nga vëzhguesi. Megjithëse një formë e tillë veprimi perceptohet si ndihmë bashkëshortore, por në fakt ajo cenon votën e lirë dhe votimin e fshehtë. Votimi familjar dallon nga “ndihma në votim”, si në rastin kur një personi i lejohet ligjërisht ta ndihmojë një votues që nuk di të lexojë apo ka pengesa fizike.

➤ **Prezenca e personave të paautorizuar në ambientet brenda dhe jashtë QV**

Sipas rregullave të parashikuara në Kodin Zgjedhor, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë anëtarët dhe sekretari i KQV-së, vëzhguesit e akredituar shqiptarë ose të huaj dhe përfaqësuesit e akredituar të medias. Por në QV 0250 është vënë re pjesëmarrja e personave të paautorizuar gjatë procesit të votimit të cilë iu është bërë thirrje të largohen nga anëtarët e KQV, por e kanë pasur të pamundur largimin e tyre dhe këto persona kanë qëndruar gjatë gjithë ditës në qendrën e votimit. Ndërsa në qendrat e tjera të monitoruara nuk janë vërejtur problematika të tilla.

Sipas nenit 106 pika 4⁸ parashikohet që anëtarët e KQV-së duhet të votojnë pasi kanë votuar të gjithë qytetarët por në QV 0319/1 një anëtar i KQV ka votuar në fillim të procesit për të testuar pajisjen elektronike të identifikimit.

Në Bashkinë Shkodër në qendrën e votimit nr.0311 anëtari i komisionit kishte ngatërruar qendrën dhe si pasojë ka patur probleme në procesin e votimit duke e vonuar atë deri në sistemimin në qendrat përkatëse të komisionerve.

Një problematikë tjetër e evidentuar nga monitoruesit tanë ishte dhe ngatërrimi i qendrës së votimit nga qytetarët .

➤ **Deklaratat Publike**

Gajtë ditës së zgjedhjeve organizata “Intelektualët e Rijnë, Shpresë”, gjithashtu doli me një deklaratë publike për të informuar qytetarët, median dhe institucionet publike lidhur me problematikat e para të evidentuara nga vëzhguesit në terren.

Deklarata u postua në video dhe në formë të shkruar në rrjetet sociale të organizatës IRSH. Këto janë deklaratime të shkurtra, të përqendruara publike, të projektuara për të thithur sa më shumë vëmendje publike në procesin dhe mbarvajtjen e procesit zgjedhor dhe për të publikuar problematikat e evidentuara.

Zgjedhësi, pasi del nga dhoma e fshehtë, e hedh fletën e votimit në kutinë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit”.

⁸ Kodi Zgjedhor neni 106 pika 4 “Anëtarët dhe sekretari i KQV-së votojnë pasi kanë votuar të gjithë zgjedhësit e pranishëm në qendrën e votimit brenda orarit të mbylljes së votimit. Rregullat e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për votimin e anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së”.

C.Mbyllja e procesit

Në përgjithësi në të gjitha QV votimi është mbyllur në orën 19:00 dhe nuk ka pasur qytetarë në pritje për të votuar pas këtij orari.

Sipas nenit 106 pika 4⁹ parashikohet që anëtarët e KQV-së duhet të votojnë pasi kanë votuar të gjithë qytetarët në pothuajë të gjitha qendrat e votimit u respektua ky rregull.

Ndërsa në QV 0319/1 një anëtar i KQV ka votuar në fillim të procesit për të testuar pajisjen elektronike të identifikimit.

Në përfundim të procesit të votimit dhe të kryerjes së veprimeve për mbylljen e kutive dhe materialeve të votimit, zarfet me fletët e votimit të përdorura dhe të dëmtuara, listat e zgjedhësve, janë mbyllur dyert e qendrës së votimit nga ana e anëtarëve të komisionit dhe nuk është lejuar asnjë vëzhgues.

Ka pasur qendra ku votimi është mbyllur me vonese si në QV 259 (19:36) Bashkia Shkodër.

Parashikimi ligjor i nenit 114 të Kodit Zgjedhor për mbërritjen pranë VNV-ve, të kutive të votimit të të gjitha QV-ve në juridiksionin e ZAZ-së, brenda 3 orësh prej mbylljes së votimit, përgjithësisht u zbatua.

⁹ Kodi Zgjedhor neni 106 pika 4 “Anëtarët dhe sekretarii KQV-së votojnë pasi kanë votuar të gjithë zgjedhësit e pranishëm në qendrën e votimit brenda orarit të mbylljes së votimit. Rregullat e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për votimin e anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së”.

5.Gjetje dhe Rekomandime

Problematikat dhe gjetjet e evidentuara si rezultat i monitorimit të zgjedhjeve parlamentare të 25 prillit 2021 nga organizata e "Intelektualët e Rijnë Sjpresë" kanë të bëjnë me mosrespektimin e kuadrit ligjor zgjedhor nga anëtarët e KQV-ve. Ka raste kur këto anëtarë nuk i njohin mirë rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe ndryshimet që i bëhen këtij kodi, ndaj rekomandohet një trajnim më i thelluar dhe më i organizuar për anëtarët e KQV-ve.

Rekomandohet ngritja e një trupe profesionale komisionerësh zgjedhorë në përbërje të komisioneve zonale të administrimit zgjedhor me individë profesionistë, pa lidhje me forcat politike. Kjo është e domosdoshme të shoqërohet me mekanizma që të garantojnë se këta individë nuk do të ndëshkohen apo shpërblehen për veprimet apo mosveprimet e tyre në zbatim të ligjit gjatë procesit zgjedhor. Gjithashtu anëtarët e KQV-ve duhet ta ndalojnë qasjen e tyre ndaj vëzhguesve zgjedhorë dhe duhet që vëzhguesve ti lejohet hapsira e nevojshme për të vëzhguar në të gjitha fazat e procesit të votimit.

Duke qënë se në zgjedhjet e këtij viti u përdor një mënyrë e re identifikimi për votuesit me anë të paisjes elektronike PEI , KQZ për kryerjen e këtij shërbimi kontraktoi një numer të caktuar personash, ku disa prej tyre janë përzgjedhur shumë pak ditë para datës së zhvillimit të zgjedhjeve dhe janë trajnuar në një kohë relativisht të shkurtër, çka ka bërë që këto persona në momentin e vendosjes në punë të kësaj paisjeje kanë hasur problematika. Këto problematika kanë bërë që në disa qendra votimi të ketë vonesa në fillimin e votimit.

Rezultatet e vëzhgimit në ditën e votimit për zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit 2021, diktojnë **rekomandime** për pjesëmarrje të plotë në votime të zgjedhësve me aftësi të kufizuara, përmes masave për të realizuar aksesin fizik të mjedisëve e mjeteve të votimit për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, si dhe për shërbime mbështetëse për të siguruar që të gjithë zgjedhësit me aftësi të kufizuara, që kanë vështirësi për të shkuar e për të marrë pjesë në votime, të mund të votojnë në mënyrë të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë.

Rekomandimet në vijim synojnë të ndikojnë në përmirësimin e situatës, duke dhënë orientime për përmirësime, si në drejtim të organizimit të shërbimeve parazgjedhore e zgjedhore për zgjedhësit me aftësi të kufizuara për identifikimin e tyre në lista, për informimit dhe ndërgjegjësimin e tyre për këtë të drejtë, transportin e përshtatur për në qendrat e votimit, përzgjedhjen e QV të përshtatura dhe/ ose përshtatjen e tyre dhe pajisjen me mjete të posaçme votimi si dhe mundësi votimi për zgjedhësit që nuk dalin dot nga shtëpia.

Të shihet me prioritet gjetja e zgjedhjeve alternative, përmes përmirësimeve ligjore, për votimin e zgjedhësve që nuk dalin dot nga shtëpia.

Të merren masa në kohën e duhur, në periudhën parazgjedhore për përgatitjen, testimin, botimin dhe shpërndarjen në kohë të mjeteve të posaçme ndihmëse për të verbërit dhe dhomat e fshehtësisë të përshtatura;

Institucionet përgjegjëse- njësitë e pushtetit vendor në bashkëpunim me KQZ, ***të marrin masa*** që QV të jenë të gjitha në objekte me hyrje të përshtatura. Për këtë: - të planifikohet ndërtimi i rampave në hyrje të objekteve me shkallë, ose të hiqen nga lista objektet me shumë shkallë dhe QV të tyre të vendosen në të tjera objekte të përshtatura

Njësitë e pushtetit vendor **të marrin masa** për informim dhe ndërgjegjësim në kohën e duhur në periudhën parazgjedhore, të zgjedhësve me aftësi të kufizuara, që të identifikohen në listat e zgjedhësve, sipas llojit të aftësisë së kufizuar, për të parashikuar për ta dhe për të realizuar, në bashkëpunim me KQZ, transport ditën e votimit, caktimin në qendra votimi të përshtatura, kërkesën për mjete të posaçme për të verbërit, dhoma të fshehtësisë të përshtatura.

Si konkluzion procesi i votimit ishte në përgjithsi i qete problematikat e ndeshura në fillimin e procesit të votimit kishin të bënin kryesisht me funksionimin e paisjes elektronike për identifikimin e zgjedhësve .

Problematika të cilat ndër vite kanë qënë prezente në procesin e votimit, kanë të bëjnë me respektimin e parimeve të rëndësishme si fshehtësia e votës, ndonse në raste më të pakta vazhdon të jetë ende një dukuri në procesin e votimit.

Lidhur me dukurinë e votimit familjar mund të themi se nuk ka qënë një problem shqetësues edhe pse janë evidentur raste të izoluara .Kjo dukuri në këto zgjedhje ka qënë disi më e kamufluar, pasi familjarët kanë përdorur shpeshhere justifikimin që familjari i tyre nuk mund të votojë vetë, pra duke i përfshirë në kategorinë e personave që nuk mund të votojnë vetë, por që mund të ndihmohen nga një familjar në procesin e votimit sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.Ndaj rekomandohet që antarët e KQV-ve të tregojnë kujdes dhe të ndjekin me përpikmëri rregullat e parashikuara nga Kodi Zgjedhor konkretisht Neni 8 i këtij kodi.

Si përfundim **rekomandohet** që KQZ të tregojë më shumë kujdes në procesin e para përgatitjes lidhur me infrastrukturen dhe materialet zgjedhore që të jenë të përshtatshme dhe t’iu ofrohen kushte dhe mundësi të barabarta për të votuar për çdo qytetar .

Gjithashtu **rekomandohet** realizimi i trajnimeve më të thelluara për anëtarët e KQV-ve dhe njohjen dhe adaptimin me ndryshimet e reja të Kodit Zgjedhor dhe respektimit me regorozitet të gjitha rregulla të parasikuara nga Kodi Zgjedhor.